
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT**

[Data 17/03/2026]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ ose

EMRI : LAYO SHPK

NIPTI : K92317014S

ADRESA : Tirane, Njesia administrative nr 11, Rruga Don Bosko, Kompleksi Fiore di Bosco,
Tiranë, Dyqanet te ndodhur ne katin perdhe te kompleksit, zona kadastrale 8310, numri i pasurise
7/8, Dyqani nr.9; Tirane.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur mbi Kufirin e lartë Monetar- Marrëveshje Kuader me
një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat deri në 24 muaj.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-69627-11-20-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Blerje materiale ortopedike dhe traumatologjike për Spitalin Rajonal Shkodër"

Fondi limit: 39,863,632 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH ose 412,496.19 (katërqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë nëntëmbëdhjetë) Euro pa TVSH

Kursi kembimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 19/11/2025 është 96.64 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e katër)

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: Datë 21/11/2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [Data 25 Nëntor 2025] [Numri 73]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1-“Albadent Group” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

L62217032L
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 33,666,007 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2-“LAYO” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K92317014S
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 35,550,300 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e treqind) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3-“OrthoNet 360” sh.p.k

L71614032H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 39,281,000 (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4- “T R I M E D” sh.p.k

K51612031J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 36,987,000 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1-“Albadent Group” sh.p.k

L62217032L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 33,666,007 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “Albadent Group” sh.p.k me NUIS L62217032L, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, për arsye se:

Operatori ekonomik “Albadent Group” sh.p.k., me NUIS L62217032L, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 1, të Kapacitetit Teknik, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, të shojcës 8, të DT, për arsye se:

- Nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi Faturat Elektronike të paraqitura përmbajnë objekt dhe zëra të cilat nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të tij ka blerje materiale specifike Ortopedike dhe Traumatologjike Kirurgjikale.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 212/2026, datë 09.02.2026.

Të vetmet furnizime të mëparshme të ngjashme që ka paraqitur ofertuesi në SPE janë faturat tatimore nr. 9901/2026, datë 25.02.2026 dhe nr. 9902/2026, datë 25.02.2026, të cilat janë kryer jashtë afatit të 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi janë kryer/gjeneruar pas datës së publikimit/shpalljes së njoftimit të kontratës në SPE dhe për rrjetohje këto fatura konsiderohen të pavlefshme.

2-“OrthoNet 360” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

L71614032H
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 39,281,000 (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “OrthoNet 360” sh.p.k me NUIS L71614032H, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, për arsye se:

Operatori ekonomik “OrthoNet 360” sh.p.k., me NUIS L71614032H, me dokumentacionin e paraqitur nuk plotëson kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon :

- Nuk përmbush gërmën a), të pikës 1, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi OE nuk ka deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të cilës/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetdeklarimeve, në Pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për Seksionet përkatëse në këtë Rubrikë:

- Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e

ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat ushtrimi të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave sa më sipër.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP me anë të vendimit Nr. 209/2025, datë 07.02.2025, i cili ka vendosur, se: “*Formulari Permbledhes i Vetëdeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhenë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të cilës/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetëdeklarimeve*”.

- Nuk përmbush gërmën b), të pikës 1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 4, të DT.
- Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.2.2, të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të shojcës 8, të DT, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.
- Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 7, të Kapacitetit Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të shojcës 8, të DT, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur deklaratë mbi origjinën e mallrave objekt prokurimi.
- Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 8, të Kapacitetit Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të shojcës 8, të DT, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur deklaratë mbi transportin e mallrave objekt prokurimi në destinacionin e përcaktuar në shtojcën 7 të DT “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1-“LAYO” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K92317014S
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 35,550,300 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e treqind) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra: *Nuk aplikohet*

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR